



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:293956
Datë: 08.01.2025
Numri i dokumentit: 06686643

C.nr. 122/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Alush Sinani, me zyrtaren ligjore Eliza Shala, duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë Rr. “Lidhja e Pejes”, Magj. Prishtine Fushë Kosovë, kundër të paditurit, A.R., ish nga Vitia, Rr ” Sherif Frangu” pn, për rimbursim te demit material dhe jo material, vlera e kontestit 715,00 euro, jashtë seancës gjyqësore më datë 08.01.2025, bie këtë:

A K T V E N D I M

NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridike kontestimore, e inicuar sipas padisë së paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë Rr. “Lidhja e Pejes”, Magj. Prishtine Fushë Kosovë, kunder të paditurit A.R., ish nga Vitia, Rr ” Sherif Frangu” pn, në, me object kontesti rimbursim i damitmaterial dhe jomaterial, vlera e kontestit 715,00 euro, për shkak të vdekjes së të paditurit.

Kjo procedure kontestimore mund te vazhdohet pas plotësimit të kushteve ligjore nga neni 280, i LPK-së.

A r s y e t i m

Paditësja, Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë Rr. Lidhja e Pejes, Magj. Prishtine Fushë Kosovë, në padinë e ushtruar më datë 22.12.2023, kishte kërkuar që i padituri A.R. nga Vitia, t`ia paguaj shumën e borxhit prej 715,00 euro, në emër të rimbursimit te demit material dhe jomaterial vlera e kontestit 715,00 euro.

Gjykata, me ndermarrjen e veprimeve procedurale, i ka derguar te paditurit aktvendimin per pergjigje ne padi se bashku me padinë dhe provat, mirëpo nga, Sherbimi i ekspeditimit të Gjykatës fletëdergesa është kthyer me arsyetim se i padituri ka vdekur, andaj Gjykata sipas detyrës zyrtare i ka derguar Zyres se Regjistrimit civil ne Viti, sherbimit te ofiçarise, kerkesë per verifikim, dhe nga pergjegja ka pranuar certifikaten e vdekjes u konstatua përmes certifikatës së vdekjes me nr. serik V 10732319, me nr. rendor 450 , e datës 05.12.2024, nga regjistri i të vdekurve se i padituri A.R., nga Vitia, kishte vdekur më datë 13.07.2021, në vendbanimin e tij në Viti.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, që të ndërpritet procedura kontestimore, për shkak të vdekjes së palës ndërgjyqëse - të paditurit.

Pasi që është konstatuar se i padituri kishte vdekur, gjykata në bazë të nenit 277, paragrafi 1. pika a). lidhur me nenin 95, të LPK-së, ka ndërprerë procedurën dhe ka vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PËR ÇËSHTJE CIVILE
2023:293956, 08.01.2025
C.nr.122/2024

G j y q t a r i
Alush Sinani

UDHËZIM PËR MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, 15 ditë pas ditës së pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.